



REPUBLIKA E KOSOVES
LIPJAN



VISIT LIPJAN

🏠 Rr. Shqipëria 28, 14000 Lipjan, Kosovë

☎ 038 200 41 508

✉ infokomuna.lipjan@rks-gov.net

🌐 <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>





LIPJAN

Si vendbanim, Lipjani njihet që nga periudha romake, si vend i rëndësishëm. Perveq Lipjanit qytet me rëndësi dhe kryqëzim i rëndësishëm i rrugëve ishte Ulpiana, e cila ndodhej në verilindje në largësi rreth 10 km nga Lipjani. Lipjani, në periudhën romake ishte kryesisht një vendbanim i vogël në rrugën për në Lissum. Identifikimi i Lipjanit me emrin Ulpiana më vonë është vërtetuar edhe me zbulimet e gërmadhave të vendbanimeve të antikës së vjetër dhe të periudhës bizantine në Lipjanin e sotëm.

Nga antika e vjetër emri Lypenion, Lypiana padyshim vihet deri te emri i tashëm Lipjan. Ky vendbanim shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, përrreth luginës së lumit Sitnicë, qyteti ishte i vogël deri në vitin 527, kurë ka pasur emrin Ulpiana. Nën themelet e kishës së vjetër në këtë pjesë të qytezës janë zbuluar themelet e bazilikës bizantine, ndërsa nga vet Lipjani janë të njohura disa monumente - epigrafe, prej të cilave vërtetohen të dhënat për ekzistimin e Ulpianës.



Komuna e Lipjanit ka pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme të rajonit. Koordinatat gjeografike të kësaj komunë shtrihen rreth $42^{\circ}31'48''$ V dhe $21^{\circ}08'19''$ L. Përmes territorit të komunës rrjedh lumi Sitnica, përreth dhe përgjatë të cilit shtrihen sipërfaqet më të plleshme bujqësore, të përshtatshme për prodhimtari bujqësore intensive. Gjithashtu, kjo komunë gjendet në afërsi të drejtpërdrejtë të qendrave më të mëdha të rajonit si;

Lipjan – Prishtinë 16.2 km

Lipjan – Mitrovicë 52.2 km

Lipjan – Prizren 57.2 km

Lipjan – Gjakovë 96 km

Lipjan – Pejë 87.1 km

Lipjan – Podujevë 46 km

Lipjan – Ferizaj 25 km

Lipjan – Gjiilan 50 km

Lipjan - Aeroporti i Prishtinës 15 km (vijë ajrore 6 km).

Territori i komunës së Lipjanit shtrihet në mes të gjerësisë gjeografike veriore 42o 44'- 42o-52' dhe të gjerësisë lindore prej 18o30'-18o45'. Ka mundësi të volitshme të shfrytëzimit të trafikut rrugor – hekurudhor e edhe atij ajror, meqenëse aeroporti gjendet në territorin e komunës dhe është nga qendra vetëm 15 km largësi. Kjo pozitë e territorit të komunës, si dhe e vetë qytetit Lipjan, paraqet rrethanë mjaft të përshtatshme për zhvillimin e mëtejshëm të komunës. Përmes territorit të komunës së Lipjanit kalon hekurudha, e cila lidh këtë territor në të gjitha drejtimet me rajonin në tërësi.

Territori i Komunës së Lipjanit kufizohet:

nga veriu dhe verilindja me komunën e Prishtinës;

nga veriperëndimi me komunën e Fushë – Kosovës;

nga perëndimi me Komunën e Drenasit dhe të Malishevës;

në jug perëndim me Komunën e Shtimës;

nga jugu me komunën e Ferizajt dhe nga lindja me Komunën e Gjilanit dhe atë të Artanës.



Në raport me qendrat tjera komunale, Lipjani gjendet në vendin e 7 sipas numrit të banorëve, në bazë shënimeve nga viti 1981. Në planin hapësinor të Kosovës në kuadër të qendrave tjera të mëdha, Lipjani, me sipërfaqen që posedon, është paraparë si venbanim i rangut III nga aspekti urban.





Parku I Qytetit dhe
Sheshi









Shtëpia e Shtjefan Gjeçovit

JANJEVA, [LIPJAN](#)

Janjeva është qytezë e vjetër multietnike. Në të jetojnë pjesëtarë të komuniteteve të ndryshme si: shqipëtarë, kroat, turq, boshnjak, rom, ashkanlinje, etj.



Janjeva përmendet nga shkrimtaret e ndryshëm si qendër e rëndësishme tregëtare qysh nga Koha e Raguzës rreth shekullit të XIII.



Peizazhe nga Janjeva





SHPELLA E MERMERTË NË GADIME, LIPJAN

Shpella para-historike e mermert në Gadimes u formua 80 milion vite më parë dhe paraqet fenomen karstik unik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Është e zhvilluar në një thjerrëz të gëlqerorëve me moshë paleozoike të mermerizuar me dimensione të vogla hapësinore e ndërftuar në rreshpet permo-triasike. Fakti se kanalet, galeritë dhe boshllëqet e kësaj shpelle janë krijuar në mermer paleozoiku e bënë këtë shpellë unike dhe te rrallë në botë. Pasuria e shpellës, e cila e bën atë unike, është prania e aragonitëve, të cilat, si zbukurime shpellash, janë ngjarje të rralla.

Kristalët e këtyre zbukurimeve në shpellë shfaqen në galerinë e Aragonitit e cila karakterizohet nga forma dhe drejtime të ndryshme të shpellës që e bëjnë shpellën veçanërisht interesante dhe tërheqëse.









BLINAJA, **LIPJAN**

Territori i Blinajës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, 15 km në perëndim të qytetit të Lipjanit.

Sipërfaqja e Blinajës është 5500 ha dhe shtrihet në territorin e tri komunave: Lipjan, Shtime dhe Drenas.

Lartësia mbidetare është prej 670 – 860 m.

Prania e 33 liqeneve dhe 60 livadheve krijon peizazhe të bukura dhe të ndryshme të cilat e bëjnë Blinajën shumë atraktive dhe tërheqëse për studiues dhe vizitorë dhe njëherit ofron kushte të volitshme për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore.





Kushtet natyrore mundësojnë kultivimin e kafshëve dhe shpezëve të egra për gjueti, që e bëjnë këtë njësi menaxhimi një lokacion të mirë për gjueti rekreative.





A nighttime photograph of a city street in Lipjan. In the foreground, a young tree with green leaves stands on the left, its branches partially obscuring the view. The street is illuminated by warm, yellow streetlights, creating a bokeh effect in the background. Several cars are visible on the road, their headlights and taillights blurred. The sky is a deep blue, suggesting dusk. A semi-transparent blue banner is positioned at the bottom right of the image.

VISIT LIPJAN